REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

Tetor 2017

Nëntor

Dhjetor

# EKONOMIA DHE BUXHETI

## Raport Mujor

# EKONOMIA DHE BUXHETI

## Raport Mujor

## Tetor 2017

© Ministria e Financave, 2017

Drejtoria e Makroekonomisë dhe Statistikave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë

www.financa.gov.al

E-mail: eva.doda@financa.gov.al
vivi.besho@financa.gov.al

# Përmbajtja

**VEÇORITË KRYESORE** ____ **2**

**ZHVILLIMET EKONOMIKE** ____ **3**

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit ____ **3**
2. Kursi Mesatar i Këmbimit ____ **4**
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave ____ **5**
4. Bilanci i Pagesave ____ **6**
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar ____ **7**
6. Kredia për Ekonominë ____ **8**
7. Oferta e Parasë ____ **9**
8. Depozitat sipas Burimeve ____ **10**

**SEKTORI FISKAL** ____ **11**

1. Buxheti i Konsoliduar ____ **11**
2. Të Ardhurat sipas Burimeve ____ **12**
3. Financimi i Bilancit Fiskal ____ **12**

**ANEKSI STATISTIKOR** ____ **13**

# Veçoritë Kryesore

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin tetor 2017 arriti në 103.1 për qind;
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin tetor 2017 ishte 1.9 për qind;
- *Kursi mesatar i këmbimit* të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin tetor 2017 ishte 113.74 lekë për dollarë dhe 133.66 lekë për euro;
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit tetor 2017 shënuan kuotën 0.81 për qind për ato 12 –mujore; 0.54 për qind për depozitat 6-mujore; 0.30 për qind për depozitat 3-mujore dhe 0.77 për qind për depozitat 1-mujore;
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 6.65 për qind për huatë 12-mujore dhe 7.39 për ato 6-mujore;
- *Oferta totale e parasë*, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,249,958 milionë lekë në muajin tetor, duke shënuar një rritje prej rreth 1.7 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- *Bilanci i përgjithshëm i pagesave* për tremujorin e dytë të 2017-ës shënoi rënie të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën -76.1 milionë euro.
- *Situata Buxhetore për periudhën janar-tetor 2017 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej rreth 3.5 miliardë lekë, që do të thotë se janë mbledhur rreth 11.6 miliardë lekë më shumë se planifikimi për këtë periudhë (ndërkohë që deficiti ishte planifikuar 15.1 miliardë lekë).*
- *Të ardhurat gjithsej të realizuara gjatë periudhës janar-tetor 2017, arritën në rreth 356.3 miliardë lekë ose afërsisht 100 % e planit për këtë periudhë.*
- *Shpenzimet gjithsej gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 359.8 miliardë lekë ose 97 % e shpenzimeve të planifikuara për këtë periudhë.*

# Zhvillimet Ekonomike

## 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin tetor 2017 ishte +1.9%. Një vit më parë ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit ishte +1.5 %.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin tetor 2017 shënoi rritje prej 0.04 për qind krahasuar me muajin paraardhës, ashtu si dhe në muajin shtator pati rritje prej 0.4 për qind. Gjithashtu përgjatë muajit gusht, indeksi ka shënuar rritje prej 0.4 për qind në krahasim me muajin paraardhës përkatës. Përsa i përket një viti më parë, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për muajin tetor 2016 shënoi rënie prej 0.3 për qind në krahasim me muajin paraardhës.

Fig-1




*Ndryshimet mujore të IÇK-së*

Burimi: INSTAT

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, ato të cilët patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin: "Ushqime dhe pije jo alkoolike" me një rritje vjetore të çmimit prej +4.0%, duke kontribuar me +1.53 pikë përqindje; "Qera, ujë, lëndë djegëse dhe energji" me një rritje vjetore të çmimit prej +1.1%, duke kontribuar me +0.23 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.9%.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit kontributin më të ulët në inflacionin e përgjithshëm e shënoi kategoria: "Veshje dhe këpucë" me një rënie vjetore të çmimit prej -0.4%, duke ndikuar negativisht me -0.02 pikë; "Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë" me një rënie vjetore të çmimit prej -0.2%, duke ndikuar negativisht me -0.01 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.9%.

Ndryshimi mujor i indeksit është +0.04%. Krahasuar me muajin shtator 2017 rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupet "Veshje dhe këpucë" me 1.6%, pasuar nga grupi "Argëtim dhe kulturë" me 0.8 %, "Shërbim arsimor" me 0.3%, etj. Ulja më e madhe e çmimeve vërehet në grupet "Transporti" me 0.3% dhe "Ushqime dhe pije joalkoolike" me 0.1%.

Tab - 1 *Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)*

| VITI | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2016 | 1.5 | 0.2 | 0.3 | 0.3 | 0.7 | 1.2 | 1.9 | 2.0 | 1.8 | 1.5 | 1.9 | 2.2 |
| 2017 | 2.8 | 2.2 | 2.1 | 1.9 | 2.0 | 2.2 | 2.0 | 1.6 | 1.6 | 1.9 | | |

*Burimi: INSTAT*

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin tetor 2017, arriti në 133.66 lekë/euro, duke shënuar rënie në vlerë me 0.08 për qind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit tetor, një euro u këmbye me 133.42 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin tetor 2017 arriti në 113.74 lekë/dollarë duke shënuar rritje me 1.46 për qind kundrejt muajit shtator 2017. Në fund të muajit tetor, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 114.71 lekë/dollarë.

Fig-2




*Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë muajit Tetor 2017*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në krahasim me muajin tetor të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është nënçmuar (mesatarisht) ndaj monedhës evropiane në masën 2.33 për qind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është nënçmuar në masën 8.31 për qind. Nën çmimi i lekut kundrejt monedhës evropiane dhe asaj amerikane, është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar.

Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, pësoi një rritje mesatare rreth 0.85 dollarë/euro. Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë,etj.

## 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit tetor 2017, normat e interesit të depozitave me afat 12 mujor shënuan vlerën më të lartë prej 0.81 për qind, pasuar nga ato me afat 1 dhe 6-mujore që arritën përkatësisht kuotën 0.77 dhe 0.54 për qind. Ndërsa normat e interesit të depozitave me afat 3 mujore arritën kuotën 0.30 për qind.

Normat e interesit të depozitave 6 dhe 3-mujore kanë shënuar rënie mujore prej përkatësisht 0.15 dhe 0.04 pikë përqindje. Ndërsa rritje mujore kanë shënuar normat e interesit të depozitave 12 dhe 1 mujore prej përkatësisht 0.07 dhe 0.09 pikë përqindje.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rënie kanë shënuar vetëm normat e interesit të depozitave me afat maturimi 3-mujore me përkatësisht 0.08 pikë përqindje. Ndërsa normat e interesit të depozitave me afat 1, 6 dhe 12 mujore kanë shënuar rritje prej përkatësisht 0.15, 0.07 dhe 0.12 pikë përqindje.

Normat e Interesit të huave 6 dhe 12-mujore gjatë muajit tetor 2017 arritën përkatësisht kuotën prej 7.39 dhe 6.65 për qind. Normat e interesit të huave 6 dhe 12-mujore kanë shënuar rritje mujore prej 0.87 për qind dhe 0.14 për qind. Ndërsa krahasuar me një vit më parë normat e interesit të huave 6 dhe 12-mujore kanë shënuar rënie prej 3.43 për qind dhe 0.14 për qind.

Normat e interesit të bonove të thesarit 12 mujore gjatë muajit tetor 2017 arritën nivelin 2.46 për qind duke shënuar kështu rritje mujore prej 0.15 për qind dhe rritje vjetore prej 0.52 për qind.

Fig. 3




***Normat e interesit për depozitat (%)***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-4




***Normat e interesit për huatë dhe bonot***

Burimi: Banka e Shqipërisë

# 4. Bilanci i Pagesave

Bilanci i përgjithshem i pagesave për tremujorin e dytë të vitit 2017 shënoi rënie të mjeteve valutore, me rreth 76.1 milionë euro. Tremujori i parë i 2017-ës u mbyll me një deficit të llogarisë korrente prej rreth 231 milionë euro, në tkurrje referuar të njëjtës periudhë të një vit më parë, me rreth 20%. Deficiti tregtar u nshtatorua me rreth 13%, në nivelin 483 milionë euro. Shkalla e ekspozimit të ekonomisë shqiptare vlerësohet në 206 milionë euro në rënie me 75 milionë euro krahasuar me një vit më parë. Flukset e kapitalit, shuma e tepricave nën zërin "Llogaria kapitale" dhe "Llogaria financiare", regjistruan një pozicion neto negativ prej rreth 238.9 milionë euro. Karakteristika strukturore e Bilancit të Pagesave paraqitet në figurën 5.

Fig-5




***Bilanci i Pagesave per T2 - 2017***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë periudhës transaksionet në llogarinë korrente vlerësohen rreth 2,758 milionë euro dhe janë zgjeruar me 12% në terma vjetorë. Deficiti i llogarisë korrente shënon 231 milionë euro, rreth 20% më i ulët krahasuar me një vit më parë. Tkurrja e deficitit korrent, këtë tremujor, u diktua nga zgjerimi i ndjeshëm në suficitin e llogarisë së shërbimeve. Ky zhvillim u mbështet nga flukset e larta hyrëse në "shërbime të tjera biznesi" si dhe në "shërbime transporti". Kompozicioni deficitit të llogarisë korrente shprehet sipas elementeve kryesorë përbërës (në terma neto) për tremujorin e parë 2017 (Fig-6):

- *(i)* bilanci tregtar me -693.6 milionë euro,
- *(ii)* shërbime neto me 210.5 milionë euro,
- *(iii)* të ardhura neto me 38.6 milionë euro,
- *(iv)* transferta neto me 213.4 milionë euro.

Fig-6




***Llogaria Korente per T2 - 2017***

Burimi: Banka e Shqipërisë

## 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit tetor 2017, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 25,280 milionë lekë krahasuar me muajin tetor të vitit 2016. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 16,212 milionë lekë.

Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë shënuar rritje me 15,641 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rritja mujore prej 7,998 milionë lekë të bankave të nivelit të dytë.

Fig-7




*Ecuria e M.V.N. të sistemit në Tetor '16 - Tetor '17*

Burimi: Banka

Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në 1,249,958 milionë lekë në muajin tetor 2017, duke shënuar rritje prej rreth 21,352 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 1.7 për qind.

Në muajin tetor 2017, sistemi bankar rezulton me rënie prej 1,310 milionë lekë ose -0.1 për qind në mjetet valutore neto krahasuar me muajin paraardhës.

Fig-8




*Agregati M3 Tetor '16 - Tetor '17*

Burimi: Banka e Shqipërisë

# 6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin tetor 2017 arriti në rreth 552,331 milionë lekë. Balanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje me vlerë 1,610 milionë lekë, ose rritje prej rreth 0.29 për qind. Struktura e kredisë sipas monedhave mbizotërohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 50.7 për qind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 279,955 milionë lekë.

Gjatë muajit tetor 2017, zëri "Korporata jo-financiare private", zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 61.1 për qind ose 337,696 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 31.88 për qind ose 176,100 milionë lekë. Zërat "Korporata jofinanciare publike" dhe "Korporata të tjera financiare" arritën respektivisht 5.34 dhe 1.49 për qind apo 29,486 dhe 8,252 milionë lekë.

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin tetor 2017, zëri "Koorporata private jofinanciare" zuri peshën më të lartë të kredive në lekë, me rreth 24.7 për qind, ndjekur nga "Sektorë të tjerë rezidentë" me rreth 19.4 për qind. "Koorporata private jofinanciare" dhe "Sektorë të tjerë rezidentë" zënë gjithashtu pjesën më të rëndësishme të kredive në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 36.4 për qind dhe rreth 12.5 për qind.

Fig-9




*Rritja e stokut total të kredive*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-10




*Përberja e kredive Tetor '17*

Burimi: Banka e Shqipërisë

# 7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 254,635 milionë lekë në fund të muajit tetor 2017. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në tetor 2017 ka shënuar rënie mujore prej 0.03 për qind si dhe rritje vjetore prej 1.16 për qind, dukë arritur nivelin 20.4 për qind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar gjithashtu rënie mujore prej 0.05 për qind dhe rritje vjetore prej 1.80 për qind, duke shënuar nivelin 25.6 për qind.

Fig-11




***Raporte të parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin tetor 2017, kanë pësuar rënie prej 9,963 milionë lekë në krahasim me muajin tetor 2016. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 83.2 për qind të tyre. Ndërsa depozitat në valutë gjatë muajit tetor 2017 shënuan rritje prej 12,711 milionë lekë, mbështetur kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 81.9 për qind të depozitave në valutë.

Fig-12




***Raporti i Depozitave ndaj M3***

Burimi: Banka e Shqipërisë

# 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit tetor 2017, zëri "Sektorë të tjerë rezidentë" zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 83.2 për qind, ndjekur nga "Koorporata të tjera jofinanciare", me rreth 12.0 për qind dhe nga "Koorporata të tjera financiare" me 2.4 për qind. "Sektorë të tjerë rezidentë" dhe "Koorporata të tjera jofinanciare" ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 81.9 për qind dhe rreth 16.0 për qind. "Sektorë të tjerë rezidentë" ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 83.2 për qind e totalit.

Fig-13




*Rritja e stokut total të depozitave*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në total, "Sektorë të tjerë rezidentë" përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 821,099 milionë lekë të depozitave totale. Ata ndiqen nga "Koorporata të tjera jofinanciare" (140,518 milionë lekë), "Koorporata të tjera financiare" (18,522 milionë lekë) dhe "Koorporata jofinanciare publike" (13,731 milionë lekë). "Qeveria lokale" kontribuoi me rreth 1,451 milionë lekë në totalin e depozitave.

Fig-14




*Përberja e depozitave Tetor 2017*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë muajit tetor 2017, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 995,323 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rënie prej rreth 1,835 milionë lekë, ndërsa krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 2,748 milionë lekë.

# Sektori Fiskal

## 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën janar-tetor 2017 janë mbledhur rreth 356.3 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 359.8 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 309.6 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 46.5 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat rreth 62% janë financime të brendshme.

Fig - 15




*Treguesit Fiskal, Tetor 2017*

Burimi: Ministria e Financave

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 242.4 miliardë lekë (ose rreth 99% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushtetit vendor rreth 16.2 miliardë lekë (ose rreth 104% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 71.5 miliardë lekë (ose rreth 105% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 17.8 miliardë lekë (ose rreth 94% e planit për periudhën janar-tetor 2017).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 309.6 miliardë lekë, 60.0 miliardë lekë (19% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 24.1 miliardë lekë (8%) për shpenzime interesi, 32.0 miliardë lekë (10%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 1.4 miliardë lekë (0.5%) për subvencione, 128.2 miliardë lekë (41%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 41.6 miliardë lekë (13%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 18.1 miliardë lekë (6%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 80% (shpenzime personeli), 64% (shpenzime për interesat), 71% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 62% (subvencione), 83% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 97% (për shpenzimet e qeverisjes vendore) dhe 79% (shpenzimet e tjera) përkundrejt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishin 60%, ndërsa financimi i huaj është 68% e planifikimit të tyre vjetor.

## 2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar-tetor 2017 ishin rreth 356.3 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 331.3 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 17.8 miliardë lekë.

Tab - 2

**Të ardhurat gjatë periudhës Janar-Tetor 2017 (mld Lekë)**
**Revenues during January-October 2017 (in billion ALL)**

| Burimi (Source) | Tetor '17 October '17 | Tetor '16 October'16 | Ndrysh(%) Chang (%) |
|---|---|---|---|
| TVSH (VAT) | 114.4 | 107.7 | 5.9 |
| Tatimi mbi fitimin (Profit Tax) | 25.3 | 23.9 | 5.9 |
| Taksa doganore (Custom Tax) | 5.3 | 4.9 | 7.4 |
| Taksat nacionale (National Tax) | 30.9 | 26.8 | 15.4 |
| Akcizat (Excise) | 37.4 | 34.5 | 8.5 |
| Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax) | 27.0 | 26.7 | 1.1 |

*Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Tetor – 2017*

*Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics:* October *– 2017*

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Deficiti prej 3.5 miliardë lekë gjatë periudhës Janar-Tetor 2017, u mbështet në vlerën 26.6 miliardë lekë nga financime të jashtme.

Për muajin Tetor 2017, disa nga treguesit kryesor fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 36.304 miliardë lekë,
- Realizimi i shpenzimeve në masën 37.278 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin tetor 2017, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga tatimet, të cilat arrijnë shifrën e 23.8 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 32.0 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 5.1 miliardë lekë.

# Aneksi Statistikor

Tab - 1

| Muaji | Mujor (Monthly) | | | | | | Mesatar Mujor (Monthly Average) | | | | | | Vjetor (Annual) | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | **2017** | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | **2017** | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | **2017** | Month |
| Janar | 0.7 | 1.0 | 0.8 | 1.4 | 0.9 | 1.5 | 0.7 | 1.00 | 0.8 | 1.4 | 0.9 | 0.9 | 1.6 | 2.7 | 1.7 | 1.3 | 1.5 | 2.8 | January |
| Shkurt | 1.3 | 1.1 | 1.4 | 2.4 | 1.1 | 0.5 | 1.0 | 1.05 | 1.1 | 1.9 | 1.0 | 1.0 | 0.6 | 2.5 | 1.9 | 2.3 | 0.2 | 2.2 | February |
| Mars | 0.4 | 0.2 | 0.5 | 0.4 | 0.5 | 0.4 | 0.8 | 0.77 | 0.9 | 1.4 | 0.8 | 0.8 | 1.0 | 2.4 | 2.2 | 2.2 | 0.3 | 2.1 | March |
| Prill | -0.1 | -0.1 | -0.6 | -0.5 | -0.4 | -0.6 | 0.6 | 0.55 | 0.5 | 0.9 | 0.5 | 0.7 | 1.6 | 2.3 | 1.7 | 2.3 | 0.3 | 1.9 | April |
| Maj | -0.8 | -1.0 | -1.1 | -1.6 | -1.2 | -1.2 | 0.3 | 0.24 | 0.2 | 0.3 | 0.2 | 0.1 | 1.9 | 2.1 | 1.6 | 1.8 | 0.7 | 2.0 | May |
| Qershor | -0.8 | -0.6 | -0.7 | -1.1 | -0.6 | -0.4 | 0.1 | 0.15 | 0.1 | 0.1 | 0.04 | 0.0 | 2.2 | 2.3 | 1.5 | 1.4 | 1.2 | 2.2 | June |
| Korrik | -0.2 | -0.8 | -0.6 | -0.7 | 0.05 | -0.1 | 0.1 | -0.03 | 0.0 | 0.1 | 0.20 | 0.3 | 2.7 | 1.6 | 1.8 | 1.3 | 1.9 | 2.0 | July |
| Gusht | 0.4 | -0.1 | 0.1 | 0.8 | 0.86 | 0.4 | 0.1 | -0.04 | 0.0 | 0.1 | 0.21 | 0.1 | 2.8 | 1.2 | 2.0 | 1.9 | 2.0 | 1.6 | August |
| Shtator | 0.2 | 0.8 | 0.3 | 0.6 | 0.40 | 0.4 | 0.1 | 0.06 | 0.0 | 0.2 | 0.17 | 0.3 | 2.6 | 1.7 | 1.5 | 2.2 | 1.8 | 1.6 | September |
| **Tetor** | 0.2 | 0.1 | 0.1 | 0.01 | -0.2 | **0.04** | 0.1 | 0.05 | 0.0 | 0.2 | 0.13 | **0.1** | 2.4 | 1.7 | 1.4 | 2.1 | 1.5 | **1.9** | **October** |
| Nëntor | 0.2 | -0.5 | -0.2 | -0.3 | 0.1 | | 0.1 | 0.01 | 0.0 | 0.1 | 0.12 | | 2.5 | 1.0 | 1.7 | 2.1 | 1.9 | | November |
| Dhjetor | 0.9 | 1.7 | 0.7 | 0.6 | 0.9 | | 0.2 | 0.15 | 0.1 | 0.17 | 0.19 | | 2.4 | 1.9 | 0.7 | 2.0 | 2.2 | | December |

*Burimi: INSTAT* *Source : INSTAT*

Tab - 2 **Kursi i këmbimit**
Exchange rate

| Monedha | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | | | | | | | | | | Currency |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Janar<br>January | Shkurt<br>February | Mars<br>March | Prill<br>April | Maj<br>May | Qershor<br>June | Korrik<br>July | Gusht<br>August | Shtator<br>September | **Tetor**<br>**October** | |
| *Mesatarja e periudhës* | | | | | | | | | | | | | | | *Average of period* |
| USD | 105.67 | 113.64 | 126.64 | 128.29 | 128.40 | 127.43 | 126.74 | 126.33 | 121.83 | 118.59 | 115.24 | 112.23 | 112.10 | 113.74 | USD |
| EURO | 140.27 | 140.11 | 137.65 | 135.27 | 136.57 | 135.59 | 135.38 | 135.42 | 134.58 | 133.21 | 132.57 | 132.53 | 133.55 | 133.66 | EURO |
| *Fundi i periudhës* | | | | | | | | | | | | | | | *In the end of period* |
| USD | 101.86 | 115.23 | 125.79 | 128.17 | 127.37 | 127.45 | 127.34 | 123.55 | 119.99 | 116.30 | 113.39 | 112.29 | 113.37 | 114.71 | USD |
| EURO | 140.20 | 140.14 | 137.28 | 135.23 | 136.39 | 135.08 | 136.13 | 135.03 | 134.19 | 132.59 | 132.98 | 133.50 | 133.70 | 133.42 | EURO |

*Burimi : Banka e Shqipërisë* *Source : Bank of Albania*

Tab - 3 **Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)**
Annual Interest Rates (in ALL)

| | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Në përqindje | | | | | Janar<br>January | Shkurt<br>February | Mars<br>March | Prill<br>April | Maj<br>May | Qershor<br>June | Korrik<br>July | Gusht<br>August | Shtator<br>September | **Tetor**<br>**October** | In percent |
| **Norma e depozitave** | | | | | | | | | | | | | | | Deposits rates |
| 12-M | 4.17 | 1.51 | 1.27 | 0.78 | 0.69 | 0.94 | 0.90 | 0.81 | 0.75 | 0.77 | 0.69 | 0.56 | 0.74 | 0.81 | 12-M |
| 6-M | 3.40 | 1.16 | 1.17 | 0.78 | 0.57 | 0.78 | 0.58 | 0.53 | 0.72 | 0.80 | 0.49 | 0.81 | 0.69 | 0.54 | 6-M |
| 3-M | 2.72 | 0.83 | 0.54 | 0.27 | 0.31 | 0.27 | 0.28 | 0.25 | 0.27 | 0.28 | 0.24 | 0.26 | 0.34 | 0.30 | 3-M |
| 1-M | 2.79 | 1.47 | 0.88 | 0.87 | 0.86 | 0.68 | 0.97 | 0.97 | 1.01 | 0.96 | 0.92 | 0.75 | 0.68 | 0.77 | 1-M |
| **Norma e huasë** | | | | | | | | | | | | | | | Lending rates |
| 12-M | 9.52 | 7.00 | 7.47 | 4.54 | 6.27 | 6.87 | 6.71 | 3.89 | 5.51 | 6.36 | 7.06 | 6.02 | 6.51 | 6.65 | 12-M |
| 6-M | 9.59 | 8.18 | 8.35 | 7.01 | 9.74 | 8.60 | 8.44 | 6.55 | 7.56 | 10.55 | 8.22 | 9.24 | 6.52 | 7.39 | 6-M |
| **Norma e letrave me vlerë** | | | | | | | | | | | | | | | Securities rates |
| Bono thesari 1/ | | | | | | | | | | | | | | | Treasury bills 1/ |
| 3-M | 3.40 | 3.15 | - | - | 1.22 | - | - | - | - | - | - | - | - | - | 3-M |
| 6-M | 3.54 | 3.16 | 2.46 | 2.00 | 2.25 | 2.01 | 1.70 | 1.52 | 1.54 | - | 1.54 | 1.65 | - | 1.82 | 6-M |
| 12-M | 3.66 | 3.33 | 2.40 | 2.92 | 3.20 | 2.93 | 2.25 | 1.79 | 1.98 | 2.04 | 2.12 | 2.20 | 2.31 | 2.46 | 12-M |

*Burimi : Banka e Shqipërisë* *Source : Bank of Albania*

Tab - 4 **TREGUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2017**

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2017

*Të dhëna progresive (Progresive Data)* *në milionë Lekë (in million ALL)*

| Nr. | E M Ë R T I M I | Janar January | Shkurt February | Mars March | Prill April | Maj May | Qershor June | Korrik July | Gusht August | Shtator September | Tetor October | ITEMS |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **TOTALI TË ARDHURAVE** | **32,893** | **64,046** | **101,554** | **140,290** | **176,744** | **212,290** | **248,616** | **284,884** | **320,072** | **356,376** | **TOTAL REVENUE** |
| I. | **Të ardhura nga ndihmat** | **186** | **644** | **1,415** | **1,933** | **2,777** | **3,592** | **4,087** | **5,051** | **5,607** | **7,096** | **Grands** |
| II. | **Të ardhura tatimore** | **30,935** | **59,660** | **94,551** | **129,856** | **163,439** | **196,233** | **230,811** | **264,780** | **298,043** | **331,393** | **Tax Revenue** |
| II.1 | **Nga Tatimet dhe Doganat** | **22,022** | **42,806** | **69,995** | **93,352** | **118,725** | **143,261** | **168,349** | **193,770** | **218,608** | **242,485** | **From tax offices and customs** |
| 1 | Tatimi mbi Vlerën e Shtuar | 10,146 | 20,237 | 31,302 | 41,918 | 53,745 | 65,757 | 78,284 | 89,798 | 101,921 | 114,448 | V.A. T |
| 2 | Tatimi mbi Fitimin | 1,620 | 3,827 | 11,177 | 13,447 | 15,326 | 17,399 | 19,291 | 21,069 | 23,465 | 25,336 | Profit Tax |
| 3 | Akcizat | 2,727 | 5,730 | 9,242 | 12,928 | 16,779 | 21,165 | 25,337 | 30,194 | 33,921 | 37,447 | Excise Tax |
| 4 | Tatimi mbi të Ardhurat Personale | 3,185 | 5,414 | 7,663 | 10,373 | 12,914 | 15,605 | 18,581 | 21,992 | 24,528 | 27,016 | Personal Income Tax |
| 5 | Taksa Nacionale dhe të tjera | 3,930 | 6,734 | 9,252 | 12,845 | 17,485 | 20,300 | 23,206 | 26,450 | 29,999 | 32,908 | National Taxes and others |
| 6 | Taksa Doganore | 414 | 864 | 1,359 | 1,841 | 2,476 | 3,035 | 3,650 | 4,267 | 4,774 | 5,330 | Customs Duties |
| II.2 | **Të ardhura nga Pushteti Vendor** | **907** | **2,398** | **3,866** | **7,869** | **9,342** | **10,928** | **12,083** | **13,733** | **15,355** | **16,271** | **Revenues from Local Gov.** |
| 1 | Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat) | 195 | 410 | 774 | 2,133 | 2,536 | 3,026 | 3,345 | 3,676 | 4,010 | 4,265 | Property Tax |
| 2 | Taksë mbi Biznesin e vogël | 2 | 8 | 31 | 204 | 220 | 234 | 246 | 251 | 262 | 272 | Small Business Tax |
| 3 | Taksa Lokale | 710 | 1,980 | 3,061 | 5,532 | 6,586 | 7,668 | 8,492 | 9,806 | 11,083 | 11,734 | Local Taxes |
| II.3 | **Të ardh nga fondet speciale** | **8,006** | **14,456** | **20,690** | **28,635** | **35,372** | **42,044** | **50,379** | **57,277** | **64,080** | **72,637** | **Social ins. contributions** |
| 1 | Sigurimi Shoqeror | 6,743 | 12,238 | 17,537 | 24,221 | 29,946 | 35,656 | 42,723 | 48,675 | 54,518 | 61,768 | Social Insurance |
| 2 | Sigurimi Shëndetsor | 1,146 | 1,970 | 2,780 | 3,922 | 4,779 | 5,651 | 6,847 | 7,718 | 8,596 | 9,809 | Health insurance |
| III. | **Të ardhura Jotatimore** | **1,772** | **3,742** | **5,588** | **8,501** | **10,528** | **12,458** | **13,718** | **15,053** | **16,422** | **17,887** | **Nontax Revenue** |
| 1 | Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë | | | | 908 | 908 | 908 | 908 | 908 | 908 | 908 | Profit transfer from BOA |
| 2 | Të ardhura nga Inst.Buxhetore | 1,320 | 2,901 | 4,108 | 5,222 | 6,794 | 8,272 | 9,221 | 10,060 | 10,969 | 11,875 | Income of budgetary institutions |
| | **TOTALI I SHPENZIMEVE** | **25,636** | **55,790** | **95,188** | **129,824** | **170,446** | **209,595** | **247,391** | **284,983** | **322,603** | **359,881** | **TOTAL EXPENDITURE** |
| I. | **Shpenzime Korrente** | **24,640** | **52,729** | **84,833** | **114,223** | **147,096** | **180,897** | **214,109** | **246,850** | **277,626** | **309,651** | **Current Expenditures** |
| I.1 | **Personeli** | **5,476** | **10,992** | **16,585** | **22,606** | **28,716** | **34,981** | **41,341** | **47,619** | **53,831** | **60,041** | **Personnel expenditures** |
| 1 | Paga | 4,700 | 9,451 | 14,257 | 19,446 | 24,696 | 30,106 | 35,601 | 41,022 | 46,364 | 51,729 | Wages |
| 2 | Kontributi për Sigurime Shoqerore | 776 | 1,541 | 2,328 | 3,160 | 4,020 | 4,875 | 5,740 | 6,597 | 7,467 | 8,312 | Social insurance contributions |
| I.2 | **Interesat** | **2,830** | **5,570** | **7,823** | **9,795** | **12,144** | **14,289** | **17,007** | **19,613** | **21,612** | **24,121** | **Interest** |
| 1 | Të Brendshme | 2,078 | 4,190 | 5,909 | 7,291 | 9,142 | 10,731 | 12,706 | 14,681 | 16,323 | 18,110 | Domestic |
| 2 | Të Huaja | 752 | 1,380 | 1,914 | 2,504 | 3,002 | 3,558 | 4,301 | 4,932 | 5,289 | 6,011 | Foreign |
| I.3 | **Shpenzime Operative Mirëmbajtje** | **1,567** | **4,503** | **8,630** | **11,105** | **14,580** | **18,273** | **21,916** | **24,680** | **27,886** | **32,037** | **Operational & Maintenance** |
| I.4 | **Subvecionet** | **55** | **108** | **242** | **340** | **634** | **845** | **997** | **1,147** | **1,294** | **1,448** | **Subsidies** |
| I.5 | **Shpenzime për fonde speciale** | **11,892** | **23,845** | **37,429** | **50,126** | **63,259** | **77,522** | **91,269** | **105,660** | **118,973** | **132,175** | **Social insurance outlays** |
| 1 | Sigurime Shoqerore | 8,645 | 17,397 | 27,010 | 36,420 | 46,160 | 56,190 | 66,121 | 76,929 | 86,903 | 96,776 | Social insurance |
| 2 | Sigurime Shëndetsore | 2,640 | 5,319 | 8,284 | 11,063 | 14,063 | 18,290 | 21,438 | 25,020 | 28,096 | 31,425 | Health insurance |
| I.6 | **Shpenzime per Buxhetin Vendor** | **1,789** | **4,855** | **8,914** | **13,269** | **18,818** | **23,946** | **28,727** | **33,508** | **37,796** | **41,691** | **Local budget expenditure** |
| I.7 | **Shpenzime të tjera** | **1,031** | **2,856** | **5,210** | **6,982** | **8,945** | **11,041** | **12,852** | **14,623** | **16,234** | **18,138** | **Other expenditures** |
| 1 | Pagesa e Papunesisë | 41 | 74 | 108 | 140 | 168 | 195 | 220 | 244 | 271 | 295 | Unemployment insurance benefits |
| II | **Fondi Rezerve, Kontigjenca** | | 0 | | 0 | 0 | 0 | | 0 | | 0 | **Reserve fund/contigency** |
| III | **Shpenzime Kapitale** | **1,254** | **3,127** | **10,300** | **15,224** | **22,266** | **26,846** | **30,796** | **35,126** | **41,336** | **46,510** | **Capital expenditures** |
| 1 | Financimi Brendshëm | 118 | 1,246 | 7,086 | 10,898 | 14,169 | 16,601 | 18,714 | 21,028 | 25,103 | 28,801 | Domestically financing |
| 2 | Financimi Huaj | 1,136 | 1,881 | 3,214 | 4,326 | 8,097 | 9,951 | 11,709 | 13,694 | 15,817 | 17,264 | Foreign financed |
| IV | **Detyrimet e prapambetuara** | | 0 | | 0 | | 0 | | 0 | | 0 | **Arrears** |
| V. | **DEFICITI** | **7,257** | **8,256** | **6,366** | **10,466** | **6,298** | **2,695** | **1,225** | **-99** | **-2,531** | **-3,505** | **CASH BALANCE** |
| V.1 | **FINANCIMI DEFICITIT** | **-7,257** | **-8,256** | **-6,366** | **-10,466** | **-6,298** | **-2,695** | **-1,225** | **99** | **2,531** | **3,505** | **CASH BALANCE FINANCING** |
| V.2 | **Brendshëm** | **-7,785** | **-18,552** | **-15,516** | **-15,343** | **-13,026** | **-9,120** | **-7,728** | **-7,274** | **-14,675** | **-23,164** | **Domestic** |
| 1 | Të ardhura nga privatizimi | 4 | 24 | 123 | 283 | 284 | 347 | 355 | 366 | 372 | 402 | Privatization receipts |
| 2 | Hua-marrje e brendshme | 7,474 | 8,681 | 11,187 | 11,815 | 13,517 | 14,238 | 13,022 | 12,750 | 13,740 | 16,135 | Domestic new borrowing (net) |
| 3 | Të tjera | -15,263 | -27,257 | -26,826 | -27,441 | -26,827 | -23,705 | -21,105 | -20,390 | -28,787 | -39,701 | Others |
| V.3 | **I huaj** | **528** | **10,296** | **9,150** | **4,877** | **6,728** | **6,425** | **6,503** | **7,373** | **17,206** | **26,669** | **Foreign** |
| 1 | Hua afatgjatë(e marrë) | 1,473 | 2,185 | 2,924 | 5,667 | 9,456 | 10,950 | 13,335 | 14,877 | 16,678 | 18,097 | Long-term foreign borrowing (gross) |
| 2 | Nga e cila nënhua | 391 | 768 | 1,128 | 1,937 | 2,697 | 3,628 | 4,548 | 5,427 | 6,129 | 6,485 | Subsidiary Loan |
| 3 | Ndryshimi i gjendjes së arkes* | -312 | -144 | 41 | -1,298 | -1,399 | -923 | -1,065 | -701 | -234 | -134 | Chang. of stat. Account |
| 4 | Ripagesat | -811 | -1,793 | -3,863 | -9,540 | -11,377 | -13,650 | -16,525 | -17,561 | -18,771 | -22,114 | Repayments |
| 5 | Mbështetje Buxhetore | 178 | 10,048 | 10,048 | 10,048 | 10,048 | 10,048 | 10,758 | 10,758 | 19,533 | 30,820 | Budgetary Support |

*Burimi : Ministria e Financave* *Source : Ministry of Finance*

*"Chang. of stat. Account" stands for the change in Foreign Financing Deposit*

* *"Ndryshimi i gjendjes së arkës" përfaqëson ndryshimin e Depozitës së Financimeve të Huaja*

Tab - 5

**Tabela e investimeve 2017**

Table of investments 2017

*Të dhëna progresive (Progresive Data)* *në milionë Lekë ( in million ALL)*

| | Janar<br>January | Shkurt<br>February | Mars<br>March | Prill<br>April | Maj<br>May | Qershor<br>June | Korrik<br>July | Gusht<br>August | Shtator<br>September | **Tetor**<br>**October** | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Financim i brendshëm** | **118** | **1,246** | **7,086** | **10,898** | **14,169** | **16,601** | **18,714** | **21,028** | **25,103** | **28,801** | **Domestic financing** |
| *Në %* | 9.41 | 39.85 | 68.80 | 71.58 | 63.64 | 62.52 | 61.51 | 60.56 | 61.35 | 62.52 | *In %* |
| **Financim i huaj** | **1,136** | **1,881** | **3,214** | **4,326** | **8,097** | **9,951** | **11,709** | **13,694** | **15,817** | **17,264** | **Foreign financing** |
| *Në %* | 90.59 | 60.15 | 31.20 | 28.42 | 36.36 | 37.48 | 38.49 | 39.44 | 38.65 | 37.48 | *In %* |
| **Totali** | **1,254** | **3,127** | **10,300** | **15,224** | **22,266** | **26,552** | **30,423** | **34,722** | **40,920** | **46,065** | **Total** |
| *Në %* | 100 | 100 | 100 | 100 | 100 | 100 | 100 | 100 | 100 | 100 | *In %* |

Burimi: Ministria e Financave Source: Ministry of Finance

Tab - 6 **TË ARDHURAT DOGANORE 2017**
**CUSTOMS REVENUES 2017**

*Të dhëna progresive (Progresive Data)* *në milionë Lekë ( in million Lek)*

| | Janar January | Shkurt February | Mars March | Prill April | Maj May | Qershor June | Korrik July | Gusht August | Shtator September | Tetor October | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Taksë doganore | 414 | 864 | 1,359 | 1,841 | 2,476 | 3,035 | 3,649 | 4,267 | 4,774 | 5,330 | Customs Duties |
| TVSH | 5,775 | 13,085 | 22,069 | 30,209 | 39,025 | 48,259 | 57,617 | 66,868 | 75,597 | 85,135 | V.A.T |
| Akcizë | 2,727 | 5,730 | 9,242 | 12,928 | 16,779 | 21,165 | 25,337 | 30,194 | 33,921 | 37,447 | Excises |
| Të tjera (Renta Minerare) | 250 | 438 | 585 | 937 | 1,078 | 1,216 | 1,374 | 1,541 | 1,738 | 1,909 | Others (Mineral Rent) |
| **TOTALI** | **9,166** | **20,117** | **33,255** | **45,915** | **59,358** | **73,675** | **87,977** | **102,870** | **116,030** | **129,821** | **Total** |

**TË ARDHURAT TATIMORE 2017 (TAX REVENUE )**

| | Janar January | Shkurt February | Mars March | Prill April | Maj May | Qershor June | Korrik July | Gusht August | Shtator September | Tetor October | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| TVSH | 4,370 | 7,151 | 9,233 | 11,709 | 14,720 | 17,498 | 20,667 | 22,930 | 26,324 | 29,312 | V.A.T |
| Tatim mbi fitimin | 1,620 | 3,827 | 11,177 | 13,447 | 15,326 | 17,399 | 19,292 | 21,069 | 23,465 | 25,336 | Profit Tax |
| Tatimi mbi të ardhurat personale | 3,185 | 5,414 | 7,663 | 10,373 | 12,914 | 15,605 | 18,581 | 21,992 | 24,528 | 27,016 | Personal income tax |
| Taksa nacionale dhe të tjera | 3,680 | 6,296 | 8,667 | 11,908 | 16,407 | 19,084 | 21,832 | 24,909 | 28,261 | 30,999 | National taxes |
